UDHËZIM
Nr.138, datë 21.1.2008

PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË KOMUNËN PASKUQAN

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5573, datë 14.1.2008 "Për caktimin e datës të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në Komunën Paskuqan të qarkut Tiranë", të nenit 60/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zyra e gjendjes civile në komunën Paskuqan, ku do të kryhen zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore, pas marrjes së listës përfundimtare të zgjedhjeve të datës 18 shkurt 2007, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të kryejë përditësimin e listave të zgjedhësve, për zgjedhjet e datës 24 shkurt 2008, jo më vonë se data 25 janar 2008, sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në të dhënat e regjistrave themeltarë me vendbanim të kësaj njësie.

2. Nënkryetari i komunës, pasi merr listën e zgjedhësve nga zyra e gjendjes civile, brenda datës 26 janar 2008, dërgon listat e zgjedhësve të përditësuara në letër dhe një kopje e tyre në format elektronik në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, brenda 24 orëve nga marrja e listave të përditësuara, i dërgon njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, listën e dublimeve të dyshuara brenda vetë njësisë së qeverisjes vendore dhe ato me njësi të ndryshme të kësaj zone zgjedhore. Për dublimet brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, i kërkon nënkryetarit të komunës, heqjen e zgjedhësit nga lista e zgjedhësve për shkak të ndodhjes më shumë se njëherë në listën e zgjedhësve.

4. Nënkryetari i komunës, pasi ka marrë vendim për heqjen nga lista e zgjedhësve, të zgjedhësve të regjistruar më shumë se njëherë, miraton listën përfundimtare të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme të datës 24 shkurt 2008, jo më vonë se data 28 janar 2008.

5. Pas miratimit nga nënkryetari i komunës, lista përfundimtare e zgjedhësve i dërgohet KZZ-së me datë 28 janar 2008, e printuar në tre formate sipas përcaktimeve të nenit 59 të Kodit Zgjedhor.

- Listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit për t'u shpallur pranë çdo qendre votimi. Një kopje e kësaj liste edhe në format elektronik i dërgohet DPGJC-së, brenda 24 orëve.
- Listë zgjedhësish në nivel njësish të qeverisjes vendore që mbahet nga KZZ-ja për informimin e zgjedhësve e renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrit të zgjedhësve.
- Listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit, e cila i dorëzohet KZZ-së për t'u përdorur nga KQV-ja ditën e votimit. Kjo listë duhet të përmbajë për çdo zgjedhës edhe emërtimin, numrin dhe faqen e regjistrit themeltar me vendbanim të gjendjes civile të njësisë përkatëse.

6. Brenda 24 orëve nga marrja e listave përfundimtare, KZZ-ja i shpall ato pranë qendrave përkatëse të votimit në një vend me hyrje të lirë.

7. Nënkryetari i komunës, pas miratimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, jo më vonë se data 14 shkurt 2008, kryen njoftimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në listat përfundimtare, me anë të grupeve dyshe të punës të ngritura për çdo qendër votimi, sipas kësaj procedure:

- Njoftimi me shkrim i zgjedhësve kryhet nga grupet dyshe të punës, të formuara nga një përfaqësues i administratës së njësisë vendore dhe një përfaqësues i caktuar nga partia më e madhe në opozitë me nënkryetarin e komunës.
- Jo më vonë se data 1 shkurt 2008, nënkryetari i komunës i kërkon partisë më të madhe opozitare, në NJQV-në e tij të caktojë personat që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës për çdo QV. Jo më vonë se data 2 shkurt 2008 subjekti politik duhet ta ketë dorëzuar listën e personave që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës.
- Me vendim, brenda datës 4 shkurt 2008, nënkryetari i komunës bën caktimin e grupeve dyshe për njoftimin e zgjedhësve për çdo qendër votimi. Njoftimi mund të kryhet edhe vetëm nga

përfaqësuesi i administratës së NJQV-së, nëse partia politike nuk respekton afatet e caktuara në këtë udhëzim, kur ajo është njoftuar me shkrim nga kryetari.

- Zyrat e gjendjes civile vënë në dispozicion të çdo grupi njoftimi brenda datës 4 shkurt, njoftimet përkatëse dhe listën përfundimtare të zgjedhësve të QV-së përkatëse.

- Grupet e punës kryejnë njoftimin për çdo familje që ndodhet në listën përfundimtare të zgjedhësve të qendrës së votimit, brenda datës 14 shkurt 2008. Kryefamiljari ose një person madhor i familjes firmos në listën e zgjedhësve, kur merr njoftimin.

8. Ndryshimet në lista pas shpalljes së listës përfundimtare bëhen në përputhje me nenin 60 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

9. Nënkryetari i komunës, vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore të regjistruara në KQZ, kopje të listës përfundimtare të zgjedhësve, jo më vonë se tri ditë nga data e paraqitjes së kërkesës dhe pa pagesë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore të regjistruara në KQZ, kopje të listës përfundimtare të zgjedhësve për njësinë, jo më vonë se tri ditë nga data e paraqitjes së kërkesës dhe pa pagesë.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani